



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit –Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport**

**STRATEGJIA KOSOVARE PËR RININË
2013-2017**

Prishtinë, Shkurt, 2013



Të dashur të rinj,
Miratimi i Strategjisë Kosovare për Rininë 2013-2017 dhe Planit të Veprimit 2013-2015 është një hap tejet domethënës në angazhimet tona të përbashkëta për fuqizimin e rinisë në jetën publike. Rinia është një prioritet nacional për shumë arsye, e në radhe të parë për pasionin e madh që ka treguar në vazhdimësi dhe për kontributin e vlefshëm që ka dhënë në të gjitha fazat e zhvillimeve në Republikën e Kosovës.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) progresivisht ka rritur përkrahjen për rininë, e në veçanti në këto dy vitet e fundit. Dhe mbështetja do të vazhdojë të rritet edhe në të ardhmen. Përveç mbështetjes direkte nga buxheti i ministrisë, ne kemi pasur shumë iniciativa të përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë, si me Bankën Botërore, USAID-in, UNICEF-in, etj., përmes të cilave kemi arritur që të përkrahim idetë dhe projektet inovative të shumë të rinjve dhe organizatave rinore.

Shumë prej tyre kanë përfituar subvencione dhe grante për realizimin e projekteve të ndryshme, e çka është më thelbësore, edhe për hapjen e bizneseve të reja, avancimin e atyre ekzistuese si dhe për trajnime profesionale në fusha të ndryshme.

Strategjia e miratuar do të avancoj edhe më shumë përkrahjen dhe, përveç MKRS-së, do të jenë edhe institucione të tjera që do të ndihmojnë në zhvillimin e politikave që do të fuqizojnë në vazhdimësi rolin e rinisë.

Ky dokument mund të mos adresojë të gjitha kërkesat që mund të ketë secili i ri në Kosovë, por është një dokument realist dhe që së bashku mund ta zbatojmë në praktikë. Unë e ftoj secilin që, duke lënë anash dallimet çfarëdo qofshin ato, të punoj për avancimin dhe fuqizimin e të rinjve të Kosovës, që pa dyshim janë jo vetëm e ardhmja, por edhe e tashmja e vendit tonë. MKRS do të jetë përherë partneri kryesor i të rinjve për arritjen e këtyre qëllimeve të përbashkëta.

Sinqerisht,

Memli Krasniqi
Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

A handwritten signature in blue ink, which appears to read 'Memli Krasniqi'.



Strategjia e Kosovës për Rininë dhe Plani i Veprimit, është një udhërrëfyes i zhvillimit afatmesëm të rinisë së Kosovës për periudhën 2013-2017. Ky dokument strategjik ngërthen në vete përkushtimin e Departamentit të Rinisë në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Qeverisë së Republikës së Kosovës, komunitetit të donatorëve dhe të gjithë akterëve tjerë në mobilizimin e të gjithë potencialeve dhe mundësive në drejtim të krijimit të një mjedisi zhvillimor më të favorshëm për rininë tonë dhe angazhimin e potencialit të saj si në sferën e zhvillimit ekonomik ashtu edhe në atë shoqëror.

Duke marrë parasysh se rinia e Kosovës përbën pjesën elite të shoqërisë sonë si nga aspekti i pjesëmarrjes së saj në shoqëri, respektivisht, në numrin e përgjithshëm të popullsisë, ashtu edhe nga aspekti i potencialit të saj strategjik në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të vendit, është nevojë e menjëhershme që këtij potenciali rinor, t'i ofrojmë kushte dhe mundësi për të qenë pjesë aktive dhe kontributëdhënëse në të gjitha fushat e zhvillimeve në vend.

Përmes kësaj strategjie ne synojmë që të krijojmë një sinergji të përbashkët me të gjithë partnerët që në formë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë i përkrahin aktivitetet rinore, në mënyrë që bashkërisht të arrijmë synimet tona, në të gjitha fushat që ndërlidhen me përmirësimin pozitiv të rinisë në jetën ekonomike dhe shoqërore.

Për më tepër ne synojmë që të fuqizojmë organizatat rinore dhe përmes tyre të krijojmë një ndërveprim të qëndrueshëm dhe një urë bashkëpunimi në mes të rinisë dhe institucioneve vendimmarrëse, gjithnjë në funksion të përkrahjes së iniciativave rinore. Në këtë mënyrë ne sigurojmë që Departamenti i Rinisë do të jetë vazhdimisht derë e hapur për adresim të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me rininë e Kosovës..

Për kontributin e dhënë në hartimin e kësaj strategjie, i falënderoj të gjitha grupet punuese, përfaqësuesit e institucioneve vendore, komunitetin e donatorëve, ekspertët dhe përfaqësuesit e organizatave rinore për përkrahjen që kanë dhënë në hartimin e këtij dokumenti strategjik.

Sinqerisht,

Xhevat Bajrami
Drejtore i Departamentit të Rinisë

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Xhevat Bajrami". The signature is fluid and cursive.

LISTA E SHKURTESAVE

MKRS	Ministra për Kulturë, Rini dhe Sport
DiR	Departamenti i Rinisë
DKRS	Drejtoritë Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport
BB	Banka Botërore
KE	Këshilli i Evropës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
QR	Qendra Rinore
KQVR	Këshilli Qendror i Veprimit Rinor
KVRL	Këshilli i Veprimit Rinor Lokal
SKPVR	Strategjia Kosovare dhe Plani i Veprimit për Rininë
UNMIK	Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNV	Vullnetarët e OKB-së
UNICEF	Fondi i OKB-së për Fëmijë
EF	Edukimi formal
EJF	Edukimi jo formal
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
MTI	Ministria e Industrisë dhe Tregtisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
FSKP	Forum Syd Programi për Kosovë
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës

Përmbajtja

I.	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	6
II.	HYRJA.....	8
	1. Nevoja për një strategji kombëtare për rini:	8
III.	PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTETET STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR RININË.....	9
	1. Parimi i ligshmërisë.....	9
	2. Parimi i pjesëmarrjes.....	9
	3. Parimi i trajtimit të barabartë.....	9
	4. Parimi i qasjes së përbashkët, ndarjes së përvojave dhe përgjegjësi.....	9
	5. Parimi për të drejtën e informimit	9
	6. Parimi i hartimit të strategjisë bazuar në dëshmi	9
	7. Parimi i qëndrueshmërisë	9
IV.	METODOLOGJIA.....	10
	1. Të dhënat themelore dhe faza e përpilimit.....	10
	2. Konsultimet në nivel lokal dhe qendrorë	10
	3. SKPVR dhe strategjitë tjera institucionale	11
	4. Skema e aktiviteteve në hartimin e SKPVR	11
V.	ANALIZA E SITUATËS:	12
	1. Pjesëmarrja e të rinjve	12
	2. Edukimi jo-formal	14
	3. Punësimi dhe Ndërmarrësia.....	14
	4. Edukimi dhe promovimi shëndetësor.....	16
	5. Siguria njerëzore.....	17
	6. Integrimi Shoqëror, Vullnetarizmi, Sporti, Kultura dhe Rekreacioni.....	17
	7. SWOT-Analiza.....	19
VI.	KUADRI STRATEGJIK – VIZIONI, MISIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE.....	20
	1. Vizioni.....	20
	2. Misioni	20
	3. Objektivat Strategjike.....	20
	3.1 Pjesëmarrja e të rinjve.....	20
	3.2 Edukimi jo-formal.....	21
	3.3 Punësimi dhe Ndërmarrësia.....	21
	3.4 Edukimi dhe Promovimi Shëndetësor	22
	3.5 Siguria njerëzore.....	23
	3.6 Integrimi shoqëror, Vullnetarizmi, Sporti Kultura dhe Rekreacioni.....	24
VII.	ALTERNATIVAT E KONSIDERUARA TË STRATEGJISË	25
VIII.	ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË	27
	1. Roli i sistemit të monitorimit	27
	2. Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim	27
	3. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.....	28

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Strategjia Kosovare për Rininë 2013 - 2017 dhe Plani i Veprimit 2013 - 2015 (SKPVR) është një strategji gjithëpërfshirëse e Qeverisë së Kosovës për të rinjtë. Ajo ka për synim përmirësimin e situatës së të rinjve të grup-moshave 15 – 24 vjeç, duke përfshirë të gjitha institucionet përkatëse qeveritare dhe joqeveritare, ndërsa kjo mendohet të bëhet me anë të hulumtimit dhe plotësimit të nevojave të rinisë, gjetjes së mënyrave dhe mekanizmave për pjesëmarrje të saj në proceset e vendimmarrjes në Kosovë. Strategjia Kosovare për Rininë 2013-2017 dhe Plani i Veprimit për Rininë 2013 - 2015 (SKPVR) do të nxitë bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore dhe Qeverisë, përkatësisht ndërmjet të gjitha ministrive, veprimtaria e të cilave lidhet me rininë, si dhe ndërmjet organizmave qendrorë dhe atyre komunalë për të fuqizuar politikat dhe programet rinore. Kjo strategji ka një ndërlidhje me strategjitë tjera qeveritare.

SKPVR përbëhet nga dy pjesë: nga vetë dokumenti i politikës apo strategjisë dhe nga plani i veprimit, i cili i bashkëngjitet këtij dokumenti si shtojcë. Kjo e fundit përmban një plan të aktiviteteve, që parashikohen gjatë kësaj periudhe sipas fushave të cekura më poshtë. Politika rinore e Kosovës fillon me përcaktim të hollësishëm të situatës së rinisë kosovare që nga prezantimi i qëndrimit të të rinjve në “thirrjen për të bërë ndryshime”, pjesëmarrja e të rinjve në edukim, punësim, shëndetësi dhe përfundon në kulturë, sport dhe rekreacion, për të renditur nëpër secilën objektivat e strategjisë në gjashtë fushat tematike të cilat ndikojnë në jetën e personit të ri siç janë: pjesëmarrja e të rinjve, edukimi, punësimi, ndërmarrësia, shëndetësia, siguria njerëzore dhe kultura, sporti dhe rekreacioni.

Qëllimi kryesor i gjithë këtyre temave është ideja e përafrimit të të rinjve kosovarë me parimet dhe praktikat më të mira evropiane. Është mendim pragmatik se të rinjtë kosovarë janë gjithashtu të rinj evropianë dhe si të tillë ata duhet të aspirojnë që të kenë të drejta të njëjta sikurse edhe gjetiu në Evropë në fushën e pjesëmarrjes, edukimit, shëndetësisë, sigurisë njerëzore, punësimin, sportin, kulturës dhe rekreacionit. Temat që i përfshinë SKPVR kanë të inkorporuar përfshirjen sociale (gjinia, etnia, rinia rurale / urbane dhe grupet tjera të marginalizuara) si qasje e përgjithshme që do të merret parasysh gjatë implementimit të aktiviteteve të parapara.

Objektivat specifike, aktivitetet, përgjegjësitë, vlerat buxhetore të SKPVR-së janë të shtjelluara më gjerësisht në matricën e Planit të Veprimit për Rini, në të cilin ndërlidhen aktivitetet konkrete me rezultatet e matshme dhe identifikohen institucionet përgjegjëse me financimin e nevojshëm (Shih shtojcën PVR).

Po ashtu, një ndër qëllimet e kësaj Strategjie është edhe përkrahja e të rinjve në fushën e inovacionit dhe ideve kreative, lëmi e cila konsiderohet si një element i rëndësishëm që ndikon në ofrimin e mundësive të reja për të rinjtë, në aspektin e edukimit, stimulimit të ndërmarrësisë dhe krijimit të mundësive shtesë për punësim, ngritjes së kapaciteteve dhe fitimit të njohurive të reja në fushën e teknologjisë informative dhe fushave tjera duke krijuar sisteme dhe aplikacione të reja që do të shërbejnë jo vetëm për avancimin e njohurive të të rinjve, por po ashtu do të përdoren edhe nga Institucionet dhe Agjencionet Qeveritare të Republikës së Kosovës.

Strategjia përmban 6 objektiva strategjike të cilat janë:

- **PJESËMARRJA E RINISË**

Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe përfshirja sa më e madhe e të rinjve në politikë-bërje sektoriale që ndikojnë drejtpërdrejt në të rinjtë.

- **EDUKIMI JO-FORMAL**

Të rinj të edukuar dhe të përgatitur për të përballuar të gjitha sfidat e jetës si anëtarë të përgjegjshëm të komunitetit vendor dhe evropian.

- **PUNËSIMI DHE NDËRMARRËSIA**

Nxitja e punësimit përmes trajnimeve dhe mbështetjes së ndërmarrësve të rinjë.

- **SHËNDETI, EDUKIMI DHE PROMOVIMI SHËNDETËSOR**

Të rinj të vetëdijësuar lidhur me rëndësinë e ruajtjes së shëndetit për mirëqenien e tyre individuale dhe shoqërore, si dhe për kontributin e tyre si qytetar të përgjegjshëm të vendit.

- **SIGURIA NJERËZORE**

Të rinjë të përgatitur për të identifikuar, parandaluar dhe adresuar me kohë në mënyrë efektive rrezikun që u kanoset të rinjve.

- **SPORTI, KULTURA DHE REKREACIONI**

Integrimi i të rinjve në jetën shoqërore, ekonomike dhe kulturore përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive .

Qasja analitike e të dhënave si dhe krahasimet e bëra në rrafshin hulumtues mundësojnë qartë definimin e problemeve, objektivave, masave që duhet të ndërmerren si dhe rekomandimin për zgjidhje të caktuara. Bazuar në politikat ndër-sektoriale dhe specifike që udhëheq MKRS, është bërë edhe përcaktimi për trajtim të tillë të sektorit të rinisë dhe është në përputhje me programet dhe aktivitetet e kësaj ministrie.

II. HYRJA

1. Nevoja për një strategji kombëtare për rinin:

Strategjia Kosovare për Rininë 2013-2017 dhe Plani i Veprimit për Rininë 2013 - 2015 (SKPVR) ka për synim përmirësimin e situatës së rinisë, duke përfshirë të gjitha institucionet përkatëse qeveritare dhe joqeveritare, organizatat dhe ofruesit e shërbimeve për hulumtimin dhe plotësimin e nevojave të rinisë dhe gjetjen e mekanizmave për pjesëmarrje të saj në proceset e vendimmarrjes në Kosovë.

Strategjia nxitë bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore dhe Qeverisë, përkatësisht ndërmjet të gjitha ministrive, veprimtaria e të cilave lidhet me rininë, si dhe ndërmjet organizmave qendrore dhe atyre komunale për të fuqizuar politikën dhe programet rinore. Plani i Veprimit për Rininë përshkruan hapat për realizimin e objektivave, zbatimin e strategjive, përcaktimin e akterëve përkatës, organizatave përgjegjëse dhe mjeteve të nevojshme financiare.

Strategjia Kosovare dhe Plani i Veprimit për Rininë është dokument strategjik që në përmbajtjen e tij përfshin interesat vitale dhe nevojat e të rinjve për periudhën kohore 2013 – 2017. Duke pasur parasysh nevojat e mëtejme dhe realizimin e kërkesave të të rinjve, dhe paraqitjen e kërkesave në rrethana të reja lidhur me zhvillimet e sotme rinore në Kosovë, por edhe përfundimin e përmbylljes së suksesshme të SKPVR 2013 – 2017, si dhe objektivat e përmbushura, ndihet një nevojë e theksuar për të vazhduar rrugën e avancimeve në vazhdimin e politikave rinore, për përcaktimin e objektivave të reja strategjike dhe hartimin e planit të ri të veprimit.

Strategjia është e bazuar në një konsensus të gjerë të të gjithë akterëve mbi objektivat strategjike duke u bazuar në prioritetet qeveritare dhe nevojave të të rinjve, si dhe në dokumentet dhe ligjet ekzistuese që autorizojnë hartimin e strategjive kombëtare qeveritare.

Dokumenti strategjik trajton preokupimet e kohës së sotme të të rinjve nga mosha 15 -24 vjeç dhe politikave ndër sektoriale në përputhje me legjislacionin në fuqi të MKRS-së.

III. PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTETET STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR RININË

Parimet e SKPVR, nënkuptojnë respektimin e të gjithë të rinjve dhe të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë në të gjitha sferat shoqërore, ekonomike, arsimore, fetare dhe kulturore me qëllim të bashkëpunimit ndërmjet të rinjve pa dallime etnike në të gjitha aktivitetet shtetërore në përputhje me parimet dhe vlerat evropiane për të drejtat e njeriut.

1. Parimi i ligjshmërisë

Strategjia Kosovare dhe Plan i Veprimit për Rininë mbështeten në Ligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të rinisë, aktet nënligjore, dokumentet strategjike relevante të Qeverisë së Kosovës dhe në parimet universale për të drejtat e të rinjve.

2. Parimi i pjesëmarrjes

Hartimi i Strategjisë, është realizuar përmes një sistemi të gjerë pjesëmarrjeje, që përfshinë institucionet qendrore, shoqërinë civile, organizatat jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, dhe partnerët ndërkombëtar. Pjesëmarrja e gjerë e grupeve të interesuara, përbën edhe një tipar dallues të kësaj strategjie. Ajo përbën një nga garancitë e suksesit të saj.

3. Parimi i trajtimit të barabartë

Përfshinë mbështetjen e të rinjve pa marrë parasysh etninë, gjininë, përkatësinë sociale dhe duke respektuar në veçanti përkrahjen e të rinjve me nevoja të veçanta dhe të rinjve të marginalizuar.

4. Parimi i qasjes së përbashkët, ndarjes së përvojave dhe përgjegjësi

Çështjet që i preokupojnë të rinjtë janë çështje ndër-sektoriale që janë para së gjithash përgjegjësi dhe obligim i ministrive të linjës dhe qeverisjes lokale, prandaj është i domosdoshëm shkëmbimi i informatave, përvojave dhe resurseve me qëllim të përmbushjes së objektivave të parapara në këtë dokument strategjik.

5. Parimi për të drejtën e informimit

Parimi i të drejtës së informimit nënkupton të drejtën për informim të të rinjve si dhe qasjen në informacione në të gjitha sferat e interesit të tyre institucional.

6. Parimi i hartimit të strategjisë bazuar në dëshmi

Çështjet rinore ndryshojnë vazhdimisht, varësisht nga trendi aktual dhe nevojat e të rinjve. Kjo strategji synon të mbështes zbatimin e objektivave të parapara dhe të përkrahë hulumtimet e vazhdueshme që identifikojnë nevojat e të rinjve dhe mundësojnë zhvillimin e politikave rinore të mbështetura në të dhëna konkrete.

7. Parimi i qëndrueshmërisë

Strategjia është konceptuar si një platformë synimesh që nxit një pjesëmarrje aktive të grupeve të interesuara në zbatimin e saj. Departamenti i Rinisë (DiR), si përgjegjës kryesor

në bashkëpunim me partnerët do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e strategjisë.

Departamenti i Rinisë (DiR), gjatë hartimit të strategjisë ka treguar kujdes të shtuar për objektivat strategjike dhe objektivat specifike, që të jenë të përcaktuara, të matshme dhe të realizueshme.

IV. METODOLOGJIA

1. Të dhënat themelore dhe faza e përpilimit

Në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2012, Departamenti i Rinisë (DiR) në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka filluar zhvillimin e SKPVR 2013 – 2017. Kjo fazë e parë kishte për qëllim shtjellimin e pesë politikave të shkruara, të cilat mbulonin fushat themelore të aktiviteteve të Departamentit të Rinisë.

SKPVR, është bazuar në dokumente vendore dhe ndërkombëtare duke analizuar raporte të ndryshme: raportet e brendshme të punës 2011 të MKRS, dhe dokumentet tjera të hartuara nga shumë institucione, si Strategjia e MASHT 2005 – 2015, Strategjia e Punës e MPMS 2010 – 2015, Plani Strategjik i MPB 2007 – 2010, Strategjia e BE 2010 – 2018, ESK, UNDP, BB si dhe anketimi i organizatave rinore, nxënësve dhe studentëve, për të pasur kështu parasysh interesimet e shumta të të rinjve rreth çështjeve shumëdimensionale që i preokupojnë ata. Gjatë këtij procesi DiR, inkuadroi palë të shumta të interesuara për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Rini në Kosovë 2013 – 2017. Pjesëmarrës në proces ishin: MPMS, MTL, MSH, MASHT, MBPZHR, MPB, Enti i Statistikave të Kosovës, DKRS, KQVR, KVRL, OJQ-të Rinore, Banka Botërore, OSBE, UNDP/UNV, UNFPA, UNICEF, Forum SYD.

Faza e përgatitjes së draftit përfshinë një numër ngjarjesh, tryeza të rumbullakëta, punëtori dhe takime me akterë relevant në fushën e rinisë. Strategjia dhe Plani Kosovar i Veprimit për Rini, merr parasysh 11 treguesit e politikave rinore, të shtjelluara nga KE-ja, BE-ja si dhe Forumi Rinor Evropian. Kjo fazë e karakterizon, gjithashtu, përgatitjen teknike dhe logjistike dhe hartimin e draft – dokumentit si dhe koston buxhetore që do të paraqitet në Planin e Veprimit.

2. Konsultimet në nivel lokal dhe qendrorë


Edhe pse është hartuar në nivel qendror të Kosovës nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Strategjia Kosovare dhe Plani i Veprimit për Rininë është një dokument i zbatueshëm për tërë rininë kosovare edhe në nivel lokal. Gjatë fazës së përgatitjes janë zhvilluar konsultime me rininë nëpër komuna, organizata rinore, organizata ndërkombëtare, zyrtarë komunalë të rinisë, si dhe të rinj të tjerë të interesuar të cilët kanë shprehur mendimet dhe rekomandimet e tyre për problemet konkrete me të cilat ballafaqohet rinia në Kosovë.

3. SKPVR dhe strategjitë tjera institucionale

SKPVR është dokument që gërsheton politikat e ndryshme ndër-institucionale dhe politikat ndër-sektoriale që i dedikohen zhvillimit rinor me qëllim të avancimit të rinjve në Kosovë. Lidhshmëria institucionale nënkupton aktivitete të përbashkëta për të përkrahur të rinjtë, të cilët përbëjnë pjesën vitale të jetës në Kosovë dhe popullatën shumicë të shtetit. SKPVR është në harmoni të plotë me strategjitë tjera zhvillimore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtueshmëri me planin afatshkurtër dhe afatmesëm të buxhetit të shtetit.

4. Skema e aktiviteteve në hartimin e SKPVR

Procesi i shqyrtimit të SKPVR-së 2013-2017



V. ANALIZA E SITUATËS:

Kosova ka një popullsi në rritje ku dominojnë grup-moshat më të reja. Të rinjtë dhe të rejtat në moshë më të re se 25 vjeç përfaqësojnë 49 përqind të popullsisë, ndërsa 19.1 përqind të të rinjve janë në moshën 15-24 vjeçare.¹

SKPVR, trajton qasje të integruar për pjesëmarrje shoqërore, ekonomike dhe politike të rinisë në shoqëri. Në veçanti në proceset vendimmarrëse, edukim formal dhe joformal në përputhje me nevojat e tregut të punës, për shërbime shëndetësore mike për të rinjtë, siguri më të madhe, punësim dhe aktivitete rekreative për të rinjtë.

Nga 200 të rinj të anketuar, rezulton se interesimi i tyre fokusohet në segmentin e edukimit formal dhe joformal; 75% e të rinjve të anketuar në këtë fushë janë deklaruar se prioriteti i tyre është mësimi formal, përderisa 25% e tyre janë deklaruar se edhe edukimi joformal ka një rol të rëndësishëm në formimin e tyre profesional. Prioriteti i dytë është punësimi; rreth 70% e të anketuarve janë përgjigjur se janë më shumë të interesuar për punësim, përderisa 50% e të rinjve kërkojnë që të kenë hapësirë më të madhe rreth stimulimit të të rinjve për të themeluar biznese, ndërkaq përkrahja ekskluzive thuhet se duhet të bëhet nga institucionet shtetërore për krijimin e lehtësirave lidhur me themelimin e bizneseve të reja.

1. Pjesëmarrja e të rinjve

Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë Nr. 03/L-145, “ka për qëllim avancimin dhe riafirmimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes, pa kurrfarë dallimi dhe përjashtimi, në zhvillimin e një shoqërie demokratike, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së të rinjve dhe të statusit të tyre shoqëror.”

Gjithashtu, ky ligj obligon institucionet e Kosovës që të sigurojnë pjesëmarrjen e të rinjve dhe të sigurojnë gjithashtu ndikimin e duhur në procese të rëndësishme vendimmarrëse për të rinjtë. Për më tepër, ky ligj, detajizon edhe disa prej fushave ku pjesëmarrja e të rinjve është e obligueshme si në:

- arsim;
- punësim;
- shëndet publik;
- çështje sociale;
- kulturë, sport dhe rekreacion;
- edukim qytetar dhe demokraci;
- ambient, planifikim hapësinor dhe zhvillim rural.

Të gjitha publikimet, raportet dhe hulumtimet e ndryshme në fushën e rinisë tregojnë se pjesëmarrja e të rinjve dhe ndikimi i tyre në shumë fusha të rëndësishme për jetën e të rinjve është simbolik dhe kjo për dy arsye: në njërën anë mundësitë e kufizuara të institucioneve publike që të përfshijnë në këto procese të rinjtë, dhe në anën tjetër kapacitetet e

¹ Enti statistikor i Kosovës (ESK), Sondazhi i fuqisë punëtore (2007)

pamjaftueshme të të rinjve dhe organizatave të tyre rinore që të jenë pjesë e këtyre proceseve².

Sipas hulumtimeve dhe raporteve të ndryshme në sektorin e rinisë, në 34 komuna janë identifikuar 88 OJQ të sektorit të rinisë. OJQ-të rinore janë partner me rëndësi për sektorin e rinisë dhe zakonisht punojnë ngushtë me zyrtarët komunal për rini dhe janë të përfshira në formulimin e planit komunal për veprim rinor. Në shumë komuna, DKRS drejton aktivitetet e rinisë në komunë përmes këtyre OJQ-ve. Në përgjithësi, 88 OJQ-të rinore përbëhen prej rreth 450 anëtarëve; 61% prej tyre janë meshkuj dhe 39% janë femra. Ata zakonisht janë profesionistë të kualifikuar me diplomë universiteti (59%) ose kanë të përfunduar shkollimin e mesëm (39%)³

Gjithashtu ekziston një rrjet i qendrave të rinisë të shpërndara nëpër komuna të ndryshme. Qëllimi i qendrave rinore, është të sigurojnë një hapësirë për të rinjtë që ata të takohen dhe të shoqërohen, të ofrojnë aktivitete kulturore dhe sportive, mbështetje profesionale dhe të nivelit të njëjtë për çështje shëndetësore dhe psiko-sociale, si dhe trajnime relevante. Gjatë hulumtimit janë regjistruar 19 qendra të rinisë në 17 komuna (51% e komunave). Këto qendra të rinisë tani veprojnë si OJQ. Procesi i hapjes së qendrave rinore në të gjitha komunat do vazhdon, me përkrahjen e DiR, DKRS dhe donatorëve ndërkombëtar⁴.

Për më tepër, në hulumtimet e kryera rezultojnë se Këshillat e Veprimit Rinor Lokal (KVRL) janë të konsoliduara, të cilat konsiderohen të jenë pjesë e shoqërisë civile. Ekzistojnë 33 KVRL, që do të thotë 89% prej 37 komunave, sipas rezultateve nga studimi. Siç shihet, katër komuna nuk kanë KVRL dhe kryesisht këto janë komuna të reja, më të vogla, ose komuna me përqindje të madhe të popullsisë serbe, por janë në themelimin e sipër⁵.

Në përgjithësi, KVRL të cilat janë regjistruar gjatë studimit, përbëhen prej 250 anëtarëve; prej tyre 38% janë femra të reja dhe 62% janë meshkuj.

Më shumë se gjysma e tyre janë të moshës prej 19 deri 25 vjeç. Rreth ¼ e anëtarëve të KVRL janë nën moshën 19 vjeç, që tregon për një përkushtim të madh nxënësve për çështjet e rinisë në nivel lokal⁶.

Zhvillimet aktuale, si politike, socio-ekonomike, kulturore, imigrimi dhe emigrimi, varfëria e zhvillime të tjera, ndikojnë direkt në nivelin e pjesëmarrjes së të rinjve, bazuar në analizat e dala nga hulumtime të ndryshme. Organizimi i të rinjve nuk është madje i kënaqshëm as në

² Shih:MPMS,Raporti i performancës vjetore,06/2010;Ministria e Punëve të Brendshme,Plani strategjik 2007-2010;Ministria e shëndetësisë, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2010-2014, Youth Volunteerism in Kosovo:an opportunity to learn ,UNDP, 2010,Pristina.

³ Fuqizimi dhe Zhvillimi i Strukturave Rinore në Kosovë Raport i Studimit themelor GIZ-EDYK, SUM Consult GmbH UBO Consulting Kosovë Shkurt 2011, fq 29

⁴ Po aty

⁵ Po aty

⁶ Fuqizimi dhe Zhvillimi i Strukturave Rinore në Kosovë Raport i Studimit themelor GIZ-EDYK, SUM Consult GmbH UBO Consulting Kosovë Shkurt 2011, fq 28

shkolla, universitete publike dhe kolegje private, aty ku më së shumti pritet vetë-organizimi i të rinjve dhe ushtrimi i ndikimit të tyre në jetën mësimore, kulturore apo edhe të lidërshiptit në kuadër të këtyre institucioneve.

2. Edukimi jo-formal

Fusha e edukimit jo-formal në shoqërinë tonë në përgjithësi gjatë zhvillimit është ballafaquar me probleme të shumta. Shumica e të rinjve si rrugë të vetme të avancimit në karrierë shohin edukimin formal pasi që kjo ide është krijuar në bazë të mungesës së ofrimit adekuat të edukimit jo-formal.

Nga rezultatet e hulumtimit, me grup-moshat 15-24 vjeç, të cilin e ka realizuar sektori për edukim jo-formal në kuadër të Departamentit të Rinisë në gjashtë mujorin e parë të vitit 2012, mbi njohuritë për edukimin jo formal, rezulton se nga 100 të rinj të anketuar, 68 % e tyre nuk janë të informuar mbi edukimin jo-formal dhe rëndësinë e tij në ndërtimin e karrierës. Gjithashtu nga 100 të rinj të anketuar të cilët kanë përfituar nga edukimi jo-formal, rezulton se 72% e të rinjve kanë pasur probleme me njohjen e vlerave të marrura nga edukimi jo-formal.

Faktorë tjetër që ka ndikuar në mos zhvillimin e edukimit jo-formal, ka qenë mungesa e bashkëpunimit me palët e interesit për njohjen e edukimit jo-formal.

Andaj, duke bërë promovimin dhe nxitjen e të rinjve për vijueshmërinë në edukimin jo-formal dhe në të njëjtën kohë duke informuar të gjitha palët e interesit mbi rëndësinë e njohjes së edukimit jo-formal, do të krijohen kushtet për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve, njohjen dhe vlerësimin e edukimit jo-formal.

Një ndër elementet e rëndësishme që ndikon pozitivisht në edukimin jo-formal është edhe përfshirja e të rinjve në projekte inovative dhe kreative, ku ata përfshihen direkt në zbatim të projekteve, gjë që ka ndikim pozitiv në plotësimin e njohurive praktike që të rinjtë i përvetësojnë gjatë ciklit normal të edukimit.

3. Punësimi dhe Ndërmarrësia

Vlerësohet që në pesë vitet e ardhme përafërsisht 200,000 të rinj do të arrijnë moshën e punësimit dhe përafërsisht 110,000 prej tyre do të hyjnë në tregun e punës, ndërsa numri i personave që arrijnë moshën e pensionimit do të jetë përafërsisht 60,000 gjatë të njëjtës periudhë. Rritja e vazhdueshme neto në ofertën e fuqisë punëtore do të rrisë më tutje nevojën për të krijuar më shumë vende të punës⁷.

Në raportin e punës apo të performancës së Departamentit të Punës, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, 06/2010 dhe 06/2011, nënvizohet se moshja prej 15-24 vjeçare, e të rinjve të papunë, vazhdimisht përballet me ngritjen më të madhe të shkallës së regjistrimit, afërsisht 1.8%, derisa grupet tjera të moshave janë më regresive.

⁷Strategjia Sektoriale 2009-2013, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Prishtinë, Qershor 2009, fq. 9

Me gjithsejt 325.261 persona të regjistruar si të papunë në shërbimet publike të punësimit në Kosovë deri në fund të vitit 2011 – duke përfaqësuar një rënie për -3.0% krahasuar me vitin 2010. Ngjashëm me vitin paraprak, të regjistruarit e papunë paraqesin një shkallë të regjistrimit të papunësisë mesatarisht rreth 35-39% nga popullata ekonomiksht aktive⁸.

Rrjedhimisht, këto statistika e bëjnë papunësinë njërën prej sfidave kryesore të shoqërisë në Kosovë. Kjo shkallë e papunësisë 37- 41 % është prej niveleve më të larta të papunësisë në rajon dhe në Evropë.

Ofrimi i trajnimeve për ngritjen e shkathtësive jetësore për të rinjtë që të përgatiten për tregun e punës varen nga sistemi arsimor i një vendi, prandaj edhe Kosova si një vend i ri nuk mund të largohet nga ky konstatim. Trajnimet për ngritjen e shkathtësive jetësore për të rinjtë që të përgatiten për tregun e punës dhe aftësimi profesional, ndikon në ngritjen dhe shfrytëzimin më të mirë të mundshëm të burimeve njerëzore që shteti ynë posedon.

Praktika në punë është një masë e tregut të punës që synon të ofrojë mundësinë e fitimit të përvojës së vlefshme në mjedisin e punës për pjesëmarrësit që kërkojnë të hulumtojnë apo fitojnë njohuri përkatëse dhe shkathtësi të kërkuara për të hyrë në fushën e caktuar të karrierës. Praktika në punë u ofrohet kryesisht personave të ri potencial që hyjnë në tregun e punës dhe personave të papunë. Ekonomia e një vendi varet nga shkathtësitë e punëtorëve të tij, mirëpo këto nuk fitohen vet.

Po ashtu, zhvillimi i biznesit rinor (ndërmarrësisë) paraqet një rëndësi të veçantë si në drejtim të krijimit të vendeve të reja të punës ashtu edhe në drejtim të zhvillimit të ekonomisë në Kosovë. Nga ana tjetër, nxitja e krijimit të bizneseve të reja krijon premisa për forcimin e kapaciteteve të të rinjve dhe nxit pavarësinë e të rinjve karshi familjes dhe shtetit.

Në kushtet e sotme ekonomike, të rinjtë hasin vështirësi të shumta për të zhvilluar aktivitete ndërmarrëse. Mosnjohja e tregut të punës; mungesa e informacioneve për zhvillimin e rrethanave të tregut si ofertës dhe kërkesës në tregun e punës; edukimi jo i mirë në ndërmarrësi; mosnjohja e bazës ligjore për t'u marrë me ndërmarrësi; mungesa e zhvillimit ideor për të ndërmarrë iniciativa për themelimin e biznesit; mungesa e besimit në vete dhe ambientit të ndërmarrësisë nëse mund të kenë sukses; mungesa e njohurive mbi kreditë dhe lehtësimet që ofrojnë bankat për biznese janë disa nga faktorët që konsiderohen si problematik. Nga kjo pikëpamje është veçanërisht e rëndësishme të ofrohet mbështetje për bizneset e reja në ndërmarrësi, mentorim dhe udhëzime për ndërmarrësit e rinj, si dhe promovim dhe zhvillim i kulturës së ndërmarrësisë.

Pjesa më e madhe e themeluesve të NVM-ve, ose 33.46%, i takojnë grup-moshës 36-45 vjeç, pastaj 29.76% e themeluesve i takojnë grup-moshës 26-35 vjeç dhe 22.48% e themeluesve i

⁸Departamenti i Punës dhe Punësimit, Puna dhe Punësimi, raporti vjetor, Prishtinë, 2011. Fq. 8

takojnë grup-moshës 46-55 vjeç. Pjesa tjetër e themeluesve iu takojnë grup-moshave 18-25 (6.39%), 55-64 (7.02%) dhe mbi 65 vjeç (0.89%)⁹.

Andaj, është e një rëndësie jetike që Kosova të investoj në një përkrahje më të madhe, për të ndihmuar të rinjtë, duke ju ofruar trajnime të nevojshme për ngritjen e shkathtësive jetësore në mënyrë që të përgatiten për tregun e punës dhe ushtrim të praktikës në punë, duke synuar përfitimin e përvojës dhe duke nxitur inovacionin për ndërmarrësit e rinj.

4. Edukimi dhe promovimi shëndetësor

Shëndeti, edukimi dhe promovimi shëndetësor sipas hulumtimit të ESPAD (European School Survey Project on Alcohol and other Drugs) realizuar nga EMCDDA (European Monitoring Center for Drugs and Drug Addiction), 40% e të rinjve kanë provuar duhanin në jetën e tyre. Sipas kësaj, prevalenca është e ngjashme me të dhënat e shteteve tjera të Evropës. Prevalenca e konsumimit është 3 herë më e lartë tek meshkujt se tek femrat.

Mbizotërimi i përdorimit të alkoolit dhe drogave tjera është rreth 23% në mesin e të anketuarve të moshës 15 dhe 16 vjeç, dhe atë djemtë 35% ndërsa femrat 15 %.

Nga rezultatet e studimit: (Vlerësimi i shpejtë dhe përgjigja 2008), të realizuar nga OBSH, UNICEF, UNFPA në mesin e të anketuarve të moshës 15-24 vjet del se 5.5% janë përdorues të përhershëm të drogave, për femrat kjo përqindje ka qenë 2.2%. Mosha e të rinjve të cilët kanë filluar të konsumojnë kanabis është mosha 17 vjeçare pa dallim në baza gjinore.

Sipas këtij hulumtimi nga përdoruesit intravenoz të drogës të grup moshës nga 19 deri 49 vjeçare, 85% janë meshkuj ndërsa 15% femra. Nga të gjithë përdoruesit intravenoz të drogave, mosha e injektimit për herë të parë ishte 14 vjeç.

Lidhur me shëndetin riprodhues është realizuar hulumtimi nga ana e Agjencionit të Statistikave të Kosovës “Anketa Demografike, Sociale dhe e Shëndetit Riprodhues” e publikuar në vitin 2011, ku 95.3% e femrave të moshës 15-49 vjeçare kanë dëgjuar për ndonjërin nga metodat e kontracesionit dhe 94.9% e tyre së paku dinë njërin nga metodat më të reja të kontracesionit. Rreth 23.2% e femrave të moshës 15-24 vjeç kanë përdorur ndonjërin prej metodave kontrceptive.

Republika e Kosovës për momentin është e kategorizuar në grupin e shteteve që ka një shkallë të ulët të epidemisë së HIV-it, me shkallën e infeksionit nën 1% brenda popullatës së përgjithshme dhe nën 5% në të gjitha grupet kyçe që janë në rrezik të rritur nga HIV-i. Një përqindje e vogël e kosovarëve deri më tani janë testuar për HIV, dhe shumë raste të tjera të HIV-it kanë mundur të kalojnë të pavërejtura. Tre për qind e meshkujve seksualisht aktiv (15-24 vjeçar; shumica të pamartuar) kanë deklaruar se kanë pasur seks me punëtore të seksit në 12 muaj të fundit .

⁹Raport – Hulumtimi i 800 Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, fq. 11, Prishtinë, 2011

Të dhënat specifike për vetëvrasjet: Në mesin e të rinjve të moshës 15-25 vjeç sipas statistikave të Policisë së Kosovës në vitin 2012 (janar-shtator) janë 8 vetëvrasje dhe 104 tentim vetëvrasje, në vitin 2011, 12 vetëvrasje dhe 171 tentim vetëvrasje . Në vitin 2010 gjithsejtë 12 vetëvrasje dhe 160 tentim vetëvrasje.

Nga kjo rrjedh se është me rëndësi të veçantë trajtimi i problemeve shëndetësore të të rinjve, si dhe ofrimi i sa më shumë shërbimeve mike për të rinjtë.

5. Siguria njerëzore

Republika e Kosovës, përkundër përmirësimeve në fushën e sigurisë dhe parandalimit të krimit vazhdon të ballafaqohet me sfida të shumta. Treguesit e ulët socio-ekonomik, ilustrojnë kontradiktat zhvillimore të vendit, të cilat kanë gjeneruar jo vetëm probleme ekonomike dhe sociale, por edhe probleme të cilat lidhen me krimin dhe rreziqet që i' u kanosen të rinjve në fushën e sigurisë njerëzore në Kosovë.

Analiza e statistikave të krimit që ndërlidhet me sigurinë e bazuar në raportet e policisë së Kosovës, vë në pah një përmirësim të gjendjes së përgjithshme në fushën e sigurisë njerëzore, krahasuar me vitin 2008, ndërsa prej vitit 2009 deri në vitin 2011, kemi një rritje prej 2 % të numrit të veprave penale të raportuara në polici¹⁰.

Megjithatë, shqetësues mbetet fakti i rritjes së disa veprave penale kohëve të fundit në Kosovë apo vazhdimi i numrit të madh të rasteve të raportuara siç janë: aksidentet në trafik, në vitin 2010 ishin 18.030 ndërsa në vitin 2011 ishin 18.888 aksidente në trafik, që do të thotë një rritje prej 4.76% në krahasim me vitin paraprak; trafikimi me qenie njerëzore, ku në vitin 2010 ishin 28 viktima kosovare, ndërsa 35 në vitin 2011; delikuenca, vjedhjet e rënda, e sidomos vetëvrasjet të cilat kanë shënuar rritje drastike viteve të fundit¹¹.

Faktorët ekonomik, krimi i organizuar, kërcënimet dhe fatkeqësitë natyrore që janë pasojë e faktorit njeri, ndikojnë në sigurinë e të rinjve. Prandaj është i nevojshëm avancimi i vazhdueshëm i komponentës së sigurisë së të rinjve në Kosovë.

6. Integrimi Shoqëror, Vullnetarizmi, Sporti, Kultura dhe Rekreacioni

Integrimi shoqëror i të rinjve në SKPVR, gjithashtu, do të arrihet përmes vullnetarizmit, sportit, kulturës dhe rekreacionit, duke bërë që të rinjtë kosovar të jenë pjesë e proceseve rinore.

Aktivitetet rinore rrisin kooperimin bazuar në diversitetin etnik dhe kulturor, që ndihmojnë në njoftimin e të rinjve për vlerat dhe pasuritë e përbashkëta kulturore të shoqërisë kosovare.

Departamenti i Rinisë vlerëson se aktivitetet vullnetare, sportive, kulture dhe rekreative, janë instrumente shumë të vlefshme në arritjen e qëllimit për integrimin e të rinjve në aspektin social.

¹⁰ Policia e Kosovës

¹¹ Raporti Vjetor 2011 i Policisë të Kosovës

Promovimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit në Kosovë ka efekte të shumta pozitive, i cili iu mundëson të rinjve të fitojnë përvoja kuptimplota që mund të rrisë bashkëpunimin ndëretnik në mesin e të rinjve në të gjithë Kosovën, pastaj të lehtësojë bashkëpunimin më të mirë në mes të organizatave (joqeveritare, qeveritare, ndërkombëtare) në nivel lokal dhe qendror.

SKPVR ka një qasje proaktive në adresimin dhe promovimin e vullnetarizmit në mesin e të rinjve në Kosovë dhe është një ndër prioritetet për institucionet, OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare në nivel lokal dhe qendror.

7. SWOT-Analiza

<p>Përparësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Infrastruktura ligjore; • Infrastruktura institucionale; • Kapacitetet institucionale; • Mbi 60 % popullata me moshë rinore; • Njohja e gjuhëve të huaja; • Shkollimi gjithëpërfshirës dhe infrastruktura publike dhe private e edukimit e kompletuar; • Studime jashtë vendi dhe kthimi i dijes në vendin tonë; • Puna praktike; • Bashkëpunimi i DiR me QAP ; • Dokumentet strategjike të MPMS,MSH,MTI,MASHT,MPB etj. 	<p>Dobësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi me DKRS; • Stimulimi jo i mjaftueshëm i të rinjve për biznes; • Programet e edukimit jo të adoptueshme me zhvillimet e tregut të punës; • Bashkëpunimi ndër ministror; • Vendimmarrja e të rinjve në nivelin lokal dhe atë qendror; • Sigurimet shëndetësore; • Përkrahja e talentëve të rinj;
<p>Mundësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i infrastrukturës për të rinj; • Përmirësimi i legjislacionit; • Inkurajimi i të rinjve në biznes; • Trajnimi për përgatitje të rinjve për tregun e punës; • Bashkëpunimi ndër sektorial; • Bashkëpunimi me donator; • Shërbimet për të rinj; • Bashkëpunimi i DiR me QAP; • Organizimi i edukimit joformal për të rinj që kanë braktisur shkollimin; • Nxitja e vullnetarizmit; • Stimulimi i stafit të DiR. 	<p>Rreziqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi ekonomik i vendit • Fondi për të rinj; • Buxhet i vogël i MKRS//DiR; • Papunësia e të rinjve mbi 58%.

VI. KUADRI STRATEGJIK – VIZIONI, MISIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

1. Vizioni

Strategjia Kosovare për Rininë 2013-2017, thërret që të rinjtë femra dhe meshkuj të Kosovës të jenë qytetarë aktivë, të shëndetshëm, të edukuar, të cilët shijojnë jetë të mirë dhe cilësore, të përgatitur për t'i përballuar të gjitha sfidat e jetës si anëtarë të përgjegjshëm të komunitetit vendor, rajonal, evropian dhe global.

2. Misioni

Misioni i Strategjisë Kosovare për Rini 2013-2017 dhe Planit të Veprimit për Rini 2013 - 2015 (SKPVR) është të mbështesë të rinjtë në Kosovë për ta bërë realitet vizionin e tyre, duke u kujdesur për shëndetin dhe sigurinë, ofrimin e edukimit cilësor gjithëpërfshirës, krijimin e mundësive për punë të mirë, pjesëmarrje aktive qytetare dhe mbështetje për realizim të plotë të pasioneve dhe aspiratave jetësore të tyre.

3. Objektivat Strategjike

3.1 Pjesëmarrja e të rinjve

Objektivi strategjik - Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe përfshirja sa më e madhe e të rinjve në politikë-bërje sektoriale që ndikojnë drejtpërdrejt në të rinjtë.

Përmirësimi i pjesëmarrjes së të rinjve në procese të rëndësishme të politikë-bërjes në nivel qendror dhe lokal, që ndikon pozitivisht në adresimin e problemeve me të cilat ballafaqohen të rinjtë në Kosovë.

Konsolidimi/funksionalizimi i KVR-ve duke rritur pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje dhe politikë bërje.

Mbështetja e sektorit rinor komunal është më rëndësi të veçantë për funksionalizim më të avancuar të sektorit të rinisë në nivel lokal.

Organet përgjegjëse për rini, do të garantojnë funksionalizimin e legjislacionit në fuqi për rini në mënyrë të duhur.

Ngritja e kapaciteteve të organizatave rinore, forcimi i tyre si dhe zhvillimi i shërbimeve për të rinjtë, do të krijoj kushte dhe mundësi më të mira për të rinjtë.

Ngritja e Qendrave Rinore si dhe përmirësimi (forcimi) dhe zgjerimi i gamës së shërbimeve rinore në Qendra Rinore, është prioritet, në mënyrë që infrastruktura rinore të ketë përmirësime të dukshme.

Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar duke shërbyer si mekanizëm për bashkëpunime të ardhshme ndërkombëtare me qëllim që sektori i rinisë në Kosovë të përafrohet me nivelin rajonal dhe ndërkombëtar.

3.2 Edukimi jo-formal

Objektivi strategjik - Të rinj të edukuar dhe të përgatitur për të përballuar të gjitha sfidat e jetës si anëtarë të përgjegjshëm të komunitetit vendor dhe evropian.

Me këtë strategji do të ndërtohet infrastruktura mbi promovimin dhe nxitjen e edukimit jo-formal, duke u bazuar në përvojat e mëhershme të DIR si dhe në kërkesat e të rinjve si rrugë alternative të avancimit në karrierë.

Gjithashtu njohja e edukimit jo-formal është shumë e rëndësishme sepse përfshinë pranimin e vlerave të ofruara nga edukimi jo-formal për të rinjtë në shoqërinë tonë. Njohja përfshinë proceset e njohjeve institucionale, sociale, formale dhe vet-njohjes së edukimit jo-formal.

3.3 Punësimi dhe Ndërmarrësia

Objektivi Strategjik-Krijimi i mundësive për punësimin e të rinjve përmes programeve trajnuese dhe mbështetjes financiare për ndërmarrësit e rinj.

Programi për punësim dhe ndërmarrësi përfshinë krijimin e mundësive për punësimin e të rinjve duke ofruar trajnime për zhvillimin e shkathtësive jetësore që të përgatitën për tregun e punës.

Gjithashtu të rinjve do ju ofrohen trajnime për edukim dhe aftësim profesional. Kjo do të arrihet duke krijuar programe në bashkëpunim me institucionet relevante në mënyrë që ndikojnë drejtpërdrejt në punësimin e të rinjve.

Praktika në punë është një masë e tregut të punës që synon të ofrojë mundësinë e fitimit të përvojës së vlefshme në mjedisin e punës për pjesëmarrësit që kërkojnë të hulumtojnë apo fitojnë njohuri përkatëse dhe shkathtësi të kërkuara për të hyrë në fushën e caktuar të karrierës. Praktika në punë u ofrohet kryesisht personave të ri potencial që hyjnë në tregun e punës dhe personave të papunë. Kjo do të arrihet në bashkëpunim me institucionet publike qeveritare dhe joqeveritare, strukturat rinore dhe sektorin privat, për zhvillimin e skemave të punës praktike dhe punës sezonale.

Ndërmarrësia tek të rinjtë, do të inkurajohet dhe stimulohet përmes organizimit të programeve trajnuese për ndërmarrësi, mbështetjes financiare përmes granteve si dhe

mentorim dhe këshillim për ndërmarrësit e rinj me qëllim të konkretizimit të ideve inovative dhe zhvillimit të bizneseve të reja.

Po ashtu, Ndërmarrësia mund të stimulohet duke përfshirë të rinjtë në mënyrë aktive dhe direkt, në programe të ndryshme që përkrahin dhe promovojnë kulturën e ndërmarrësisë që mund të shpie deri tek iniciativat biznesore (biznese të reja fillestare dhe inovative).

3.4 Edukimi dhe Promovimi Shëndetësor

Objektivi Strategjik - Vetëdijësimi i të rinjve lidhur me rëndësinë e ruajtjes së shëndetit për mirëqenien e tyre individuale dhe shoqërore, si dhe për të dhënë kontributin e tyre si qytetar të përgjegjshëm të vendit.

Strategjia do të synoj promovimin e mënyrës së shëndetshme të jetesës dhe krijimin e shprehive të cilat do të ndihmojnë në ruajtjen e shëndetit të të rinjve. Përveç kësaj synohet një bashkëpunim i ngushtë ndër sektorial me palët e interesit përgjegjës për shëndetin e të rinjve, meqenëse për të realizuar këtë objektivë nevojitet aktivizimi i mekanizmave të ndryshëm në nivel qendror dhe lokal.

Në këto korniza do të synohet edhe përmirësimi i shërbimeve shëndetësore për të rinjtë, me rritje të kualitetit të shërbimeve dhe informim të të rinjve për mënyrën e qasjes në këto shërbime.

Zhvillimi i politikave mbështetur në dëshmi për kërkesat dhe nevojat e të rinjve, synohet të arrihet përmes të dhënave ekzistuese dhe hulumtimeve që do të realizohen gjatë zbatimit të kësaj strategjie. Përmes hulumtimeve do të identifikohet gjendja në terren dhe do të vendosen masat adekuate të nevojshme për përmirësimin e saj.

Gjithashtu, kjo strategji synon të realizoj standardet për edukimin shëndetësor bashkëmohatar, në mënyrë që të jenë të qarta kornizat që një të riu i mundësojnë të jetë një edukator bashkëmohatar, i informuar dhe i aftë për të transmetuar dijen e tij tek të rinjtë tjerë.

Ofrimi i një pakoje të shërbimeve bazë për shëndetin riprodhues të pajisur me informacion dhe edukim të sigurt për parandalimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS do të realizohet duke krijuar një sinergji resursh të brendshme dhe të jashtme bashkëpunuese me Sektorin për Edukim dhe Promovim Shëndetësor.

Vetëdijësimi i të rinjve për rëndësinë dhe pasojat e përdorimit të substancave që shkaktojnë vartësi, zbatimi i masave parandaluese, duke zbatuar ligjet në fuqi, si dhe bashkëpunimi i ngushtë me ministritë e linjës dhe mekanizmat tjerë bashkërendues është synim i kësaj objektive.

Nevoja për ngritjen e kapaciteteve trajnuese duke ngritur nivelin dhe kualitetin e trajnimeve, forcuar bashkëpunimin me infrastrukturën ekzistuese rinore, si dhe duke vendosur standarde në këtë drejtim është një nevojë e menjëhershme për realizimin e kësaj objektive.

Avokimi për krijimin e fondit të sigurimeve shëndetësore publike, është treguar një nevojë e domosdoshme veçanërisht me shtimin e numrit të të rinjve që vuajnë nga sëmundje të rënda.

Mbrojtja e mjedisit dhe ndikimi i saj në shëndet synohet të realizohet në bashkëpunim me sektorin e sigurisë njerëzore për të trajtuar këtë çështje nga aspekti i edukimit shëndetësor dhe rreziku i ndotjes së mjedisit. Meqenëse sëmundjet e lidhura me mjedisin e ndotur janë sëmundje të parandalueshme dhe janë prioritete të shëndetit publik në mbarë botën, përkrahja e iniciativave dhe vetëdijësimi i të rinjve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe krijimin e sistemeve të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave është i një rëndësie jetike për mirëqenien e popullatës.

3.5 Siguria njerëzore

Objektivi Strategjik - Të rinj të përgatitur për të identifikuar, parandaluar dhe adresuar me kohë në mënyrë efektive rrezikun që u kanoset.

Përmes kësaj strategjie do të ndërmerren veprime konkrete për parandalimin e delikuençës dhe formave tjera të krimit ku kryesisht të rinjtë janë viktimat. Kjo do të arrihet përmes fushatave të orientuara sipas rekomandimeve të nxjerra nga aktivitetet e zhvilluara në fushën e sigurisë njerëzore nga viti 2010-2012. Për realizimin me sukses të kësaj objektive do të fokusohet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e sigurisë me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së të rinjve në Kosovë nga fenomenet negative si delikuenca dhe format tjera të krimit ku të rinjtë janë viktimat apo pjesëmarrës në vepra të jashtëligjshme.

Siguria Njerëzore sipas konceptit të kësaj strategjie do të përqendrohet në promovimin e dialogut ndër – etnik për rritjen e sigurisë së të rinjve si dhe koordinimin e aktiviteteve në nivel lokal dhe qendror për të përmirësuar sigurinë e të rinjve.

Përmes hulumtimit dhe analizave për sigurinë e të rinjve do të përqendrohemi në identifikimin dhe shkaqet që shtyjnë të rinjtë të janë viktimat të abuzimit apo shfrytëzimit nga grupe të ndryshme të jashtëligjshme.

Bashkëpunimi ndërkuftar për çështjet e sigurisë për të rinj dhe promovimi i lirisë së lëvizjes është e përqendruar përmes vetëdijësimit të të rinjve për rreziqet dhe pasojat e kontrabandimit dhe trafikimit ndërkuftar të njerëzve e në veçanti të të rinjve. Gjithashtu, të evokohet për mungesën e lirisë së lëvizjes për të rinjtë kosovar, në forumet përkatëse vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.

Siguria njerëzore kërkon kuptimin e vërtetë të të drejtave të njeriut përmes bartjes së dijes, ndërtimit të aftësive dhe dimensionit të formimit të sjelljeve. Siguria njerëzore gjithashtu ngrit vetëdijen e të rinjve për mbrojtjen e dinjitetit dhe integritetit njerëzor. Në këtë fushë, synohet që rezultatet të arrihen përmes promovimit të instrumenteve ndërkombëtare dhe legjislacionit vendor për të drejtat e njeriut me theks të veçantë në mbrojtjen e të rinjve.

3.6 Integrimi shoqëror, Vullnetarizmi, Sporti Kultura dhe Rekreacioni

Objektivi Strategjik – Ngritja e nivelit të përfshirjes sociale në jetën shoqërore si dhe zhvillimit (organizimit/performancës/realizimit) të aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive dhe rekreative për të rinjtë.

Integrimi shoqëror i të rinjve në Kosovë, deri më sot, nuk është trajtuar në mënyrë të planifikuar dhe të organizuar, mirëpo, në baza të nevojave të kohës gjithmonë ka qenë pjesë e aktiviteteve të rregullta të realizuara në fushën e rinisë. Përmes kësaj objektive synohet që çështjet që kanë të bëjnë me integrimin shoqëror, të adresohen në mënyrë adekuate dhe të planifikuar.

Në anën tjetër, numri i madh i të rinjve të cilët nuk janë të inkuadruar në asnjë aktivitet, ose kanë qasje të kufizuara në aktivitetet rinore paraqet shqetësim të madh dhe së këndejmi një politikë më e strukturuar është mëse e domosdoshme.

Të mbështeten aktivitetet e përgjithshme kulturore dhe sportive të të rinjve, duke përfshirë edhe aktivitetet jashtë plan-programit shkollor në shkolla si dhe të përkrahen aktivitetet në kuadër të muajit të rinisë, aktivitet tradicional i cili organizohet për të rinjtë tashmë për 10 vite me radhë.

Të mbështeten shkëmbimet e eksperiencave në nivel ndërkombëtar të artistëve dhe sportistëve të rinjë, duke i bërë të rinjtë kosovar pjesë të proceseve rinore ndërkombëtare.

Sensibilizimi për mos-braktisjen e shkollës nga të rinjtë

Mbështetja e praktikave të mira të punës vullnetare duke i angazhuar të rinjtë në ofrimin e shërbimeve vullnetare me qëllim të përfitimit të përvojës dhe vlerave humanitare etj.

Rritja e kohezionit social ndëretnik në mes të të rinjve në mënyrë që të rinjtë e komuniteteve të ndryshme të bashkohen dhe bashkëpunojnë për një të ardhme të përbashkët.

Përfshirja e të rinjve nga zonat rurale dhe femrave të reja me mundësi më të (pakta) kufizuara në aktivitetet ekonomike dhe shoqërore.

Inkurajimi i përfshirjes sa më të madhe të të rinjve me nevoja të veçanta në aktivitetet gjithëpërfshirëse socio-ekonomike.

VII. ALTERNATIVAT E KONSIDERUARA TË STRATEGJISË

Objektivat strategjike kanë për qëllim avancimin e rolit të të rinjve në përgjithësi në shoqërinë kosovare, barazinë në trajtimin e të gjithë të rinjve dhe avancimin e çështjeve rinore në fusha të ndryshme të jetës së të rinjve.

SKPVR në suaza të veprimit të vet trajton të gjitha çështjet që janë vitale për të rinj, duke ushtruar kujdesin primar për jetën e të rinjve dhe ndihmuar ata të përfitojnë dhe avancojnë statusin e tyre të edukimit jo formal, promovimin dhe trajnimin në fushat e ndërmarrësisë, nxitjes së punësimit, promovimin dhe edukimin shëndetësor, çështjet e sigurisë, rekreacionit, argëtimit dhe sportit.

Trajtimi i çështjeve rinore bëhet përmes adresimit të problemeve rinore duke ofruar perspektivën e zhvillimit të mirëqenies dhe formimit të personalitetit të tyre të pavarur në rrethanat aktuale të veprimit rinor, duke pas parasysh nevojat e të rinjve bazuar në kërkesat e tyre.

SKPVR ofron alternativa të mjaftueshme dhe të qëndrueshme në trajtimin e problemeve rinore, që mundësojnë avancimet në shumë fusha apo dimensione shoqërore, duke ju ofruar zhvillim dhe perspektivë të gjithë të rinjve në fushën e integriteteve evropiane. Ngritja e të drejtave të të rinjve në nivele të prioriteteve shtetërore tregon qartë angazhimin e institucioneve për mbështetjen e të rinjve, gjë që kjo SKPVR i trajton në mënyrë adekuate proceset nëpër të cilat po kalon rinia e vendit tonë.

SKPVR përmes objektivave në mënyrë unike paraqet problemet dhe angazhohet për alternativat e mundshme të zbatueshme në rrethanat e tanishme në vendin tonë, duke përfshirë qasjen ndaj tyre: në ngritjen e kapaciteteve rinore, infrastrukturën, afirmimin e rolit të të rinjve dhe punëtorit rinor, edukimin e vazhdueshëm dhe gjithë-përfshirës në ofrimin e edukimit dhe promovimit të vlerave të tyre rinore në dimensione edukative, nga rrafshi i edukimi jo formal, fusha e menaxhimit dhe kreativitetit të ndërmarrësisë së të rinjve, nxitjen e punësimit, përfshirjes së barabartë sociale të të gjithë të rinjve, dhe ofrimin e një varg informacionesh të nevojshme që ndihmojnë formimin e të rinjve dhe përgatitjen e tyre në ciklet tjera të jetës.

Alternativat e prezantuara në SKPVR do të ndryshojnë jetën e të rinjve në periudhën vijuese duke stimuluar ata të jenë kreativë dhe produktivë në nxjerrjen e njohurive dhe përgatitjen e tyre të përgjithshme, për të ndërtuar vlera të mirëfillta individuale

dhe kolektive, si dhe qasje pragmatike ndaj zhvillimeve të dukurive të ndryshme shoqërore, dhe adaptimin e tyre në përputhje me rrethanat aktuale.

Propozimi i një varg alternativave që kanë buruar nga analiza e gjendjes aktuale manifestohen në gjetjen e zgjidhjeve adekuate për problemet e të rinjve që janë të përmbledhura në mënyrë detale (njehërit) edhe në planin e veprimit, njëkohësisht implementimi i objektivave specifike janë refleksione, që pritet të ndodhin në periudhat e ardhshme përmes aktiviteteve që do të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes aktuale të të rinjve në periudhën vijuese.

Alternativat e konsideruara përmes kësaj SKPVR, gjithashtu sjellin mundësi objektive për ndryshime pozitive në jetën e të rinjve, duke përfshirë fusha të gjera të zhvillimeve shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Këto alternativa begatojnë angazhimet e përgjithshme institucionale për integrimin e të rinjve në Bashkimin Evropian nën moton "të rinjtë kosovar në veprim", të gatshëm për t'iu bashkangjitur zhvillimeve evropiane rinore, pra këto objektiva kanë për qëllim zhvillimin e të rinjve dhe fuqizimin e ndikimit të tyre në jetën institucionale të vendit tonë.

VIII. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË

1. Roli i sistemit të monitorimit

Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të objektivave strategjike dhe objektivave specifike të saj. Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesorë të procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimet e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga DiR dhe institucionet përgjegjëse me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesuara.

Monitorimi dhe vlerësimi final i Strategjisë dhe PVR është pjesë integrale e detyrave dhe përgjegjësisë të divizioneve në kuadër të Departamentit të Rinise, procesi i vlerësimit do të shoqërohet edhe me ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për zyrtarët për monitorim dhe vlerësim të strategjisë dhe planit të veprimit për rini të cilët do të jenë pjesë e realizimit të kësaj Strategjie.

Fushat kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë janë:

1. Kapacitetet institucionale për zbatimin e SKPVR-së,
2. Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse,
3. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

Burimet e informatave

2. Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet bartëse dhe përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategji dhe Planin e Veprimit.

DiR, si bartëse dhe përgjegjëse kryesore për realizimin e objektivave, do të monitorojë treguesit më të rëndësishëm që kanë të bëjnë me implementimin e strategjisë. Në fund të çdo viti, DiR përgatit një raport progresi për shkallën e realizimit të objektivave, të cilin e publikon dhe e bën të njohur për të gjithë akterët e interesuar qeveritare dhe jo-qeveritare.

Ministritë pjesëmarrëse në grupin punues (MASHT, MEF, MMPH, MPMS, MSH), do të raportojnë mbi monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve që kanë si bartës këto ministri ose institucione në varësi të tyre. Këto institucione do të raportojnë periodikisht në DiR, në mënyrë që raportet të jenë të unifikuara. Gjithashtu, të gjitha institucionet relevante të përfshira si bartëse ose partnere në PVR, do të jenë të involvuara në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë.

Organizatat jo-qeveritare, do të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë në tryeza të përbashkëta që do të organizohen nga DiR. Në këto tryeza, shoqëria civile do të paraqesë raporte që lidhen me projektet dhe programet për rininë që ato kanë realizuar.

3. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të shpërndahen për të bërë të njohur progresin SKPVR-se për arritjen e objektivave strategjike dhe objektivave specifike. Pasi të hartohen raportet e progresit, bazuar mbi të dhënat dhe vërtetimet, ato do të shpërndahen ndërmjet përdoruesve të cilët do të jenë;

- Institucionet shtetërore qendrore dhe lokale,
- Shoqëria civile,
- Partnerët ndërkombëtar,
- Media,
- Publiku i gjerë.

Përgjegjës kryesor për shpërndarjen e rezultateve është Departamenti i Rinisë. Gjithashtu publikimi i rezultateve do të bëhet edhe nëpërmjet medias ose duke organizuar seminare dhe tryeza, për të nxjerrë konkluzione në lidhje me ecurinë e strategjisë duke angazhuar në mënyrë të veçantë shoqërinë civile.